

Një vështrim në arkitekturën e gjelbër/ ekologjike dhe ndërtimi natyror

Teuta Jashari-Kajtazi*

Përmbledhje

Fjalët kyçe: arkitektura organike, arkitektura eko-miqësore, natyra

ation and similar papers at core.ac.uk

broug

provided b

pohimin se arti i ndërtimit është në një fazë të re e cila padyshim do të ndryshoj mënyrën tonë të jetesës, gjithmonë në përputhshmëri me gjuhën e natyrës.

Fjalët kyçe: arkitektura organike, arkitektura eko-miqësore, natyra e krijuar nga njeriu, format biomorfe në arkitekturë, shprehja astrofizike në arkitekturë, përfshirja në skulpturat e mjedisit, eradrita dhe bimësia, energjia e diellit dhe eko-teknologjia.

Arkitektura e shekullit 20-të filloi si manifestim i epokës së industrializimit dhe teknologjisë, mirëpo në vitet e 90-ta ka filluar të ndryshoj me një shpejtësi të madhe në një epokë të re të informimit dhe ekologjisë.

Njëra nga çështjet më të ndërlikuara dhe më problematike të cilat i takojnë njerëzimit në shekullin në vijim është se si të konstruktohet vendbanimi në harmoni me natyrën, duke pasur parasysh gjithmonë një dialog kreativ e jo ndonjë zgjedhje e cila do të ishte utopike.

Në kohën kur Moderna e vonshme arriti ndikimin e vet mbizotërues, paralelet në mes të prodhimit industrial dhe shprehjes në formë kuptoheshin me mjaftë lehtësi. Në mënyrë të ngjashme, fundi i shekullit 20-të krijoi dëshmi mjaftë të theksuara të teknologjisë së ambientit/ mjedisit dhe peizazhit natyror të shndërruar në ikonografi arkitekturore të epokës së ekologjisë.

* MA.Teuta Jashari-Kajtazi, IDA. Universiteti AAB-Rinvest, FAA - Arkitekturë, Historia e Arkitekturës

Përshkrimi klasik i Le Corbusier-ut “*makinat për të jetuar në to*” përdorur për ndërtesa shumë funksionale të banimit, mund të përdoret edhe në rastin e botës duke bërë kështu ndërlihdjen e spektrit të gjerë me epokën e re të mjedisit. Edhe përkrahësit më të mëdhenj të dizajnit ekologjik janë duke luftuar për të gjetur mënyrat për harmonizimin e teknologjisë së mjedisit, mbrojtjes së burimeve dhe përmbajtjes estetike. Pa këto tri elemente përbërëse ka shumë pak mundësi të arrihet deri te një arkitekturë e qëndrueshme.

Zëri më i fortë i rezistencës dhe novator i rrallë veprat e të cilit i dhanë formë parimeve bazë të harmonizimit të arkitekturës me kontekstin, është ai i Frank Lloyd Wright-it.¹

Ky gjeni mbresëlënës mund të konsiderohet si parashikues i lëvizjes së ambientit/ mjedisit që në vitet e 10-ta të shekullit 20-të, shumë para hyrjes në përdorim të gjerë të fjalës “*Ekologji*”.²



F. Ll. Wright: “*Shtëpia Ujëvare*”, Bear Run – Pennsylvania,

¹ Arkitekt me famë/ SHBA: inicialet F.L.W; më shumë informata në www.franklloydwright.org

² Mendim: F.L.W: Do të kisha dashur të kam një arkitekturë të lirë. Arkitekturë e cila i takon hapësirës/ vendit në të cilin shihet duke qëndruar – dhe është zbulim i peizazhit e jo shëmtim. (www.geocities.com/SoHo/1469/flw)

Një nga problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet arkitektura e mjedisit, duke lënë me një anë mungesën e një qëndrimi të fortë shoqërorë, është një zgjedhje profesionale të tej-theksohen përparësitë e teknologjisë dhe të nën vlerësohen aspekti shoqëror dhe ai estetik. Pikësynim i cili harmonizon këtë situatë është të shikohet teknologjia e mjedisit si një vegël pune dhe shkenca natyrore si burim bazë i frymëzimit.

Kategoritë në mënyrë të përgjithësuar të cilat mund të karakterizojnë arkitekturën eco-miqësore (eco-friendly) do të mund të definoreshin si në vazhdim:

- Shkrirja e arkitekturës në peizazh,
- Kombinimi apo lidhshmëria e objektit me hapësirën e kopshtit apo ambientit,
- Përdorimi i simbolizmit të natyrës me qëllim të krijimit të lidhshmërisë së arkitekturës me kontekstin e saj kulturor,
- Studimet e teknologjisë së mjedisit të cilat krijojnë një bazë të arkitekturës së përgjegjshme ekologjike dhe të qëndrueshme,
- Dizajni i mjedisit si dhe teknikat e ndërtimit të cilat i japin përkrahje pranimit të ri të “arkitekturës së gjelbër” dhe shkrirjes së objekteve në kontekstin,
- Idetë largpamëse në arkitekturë dhe planifikim urban të cilat ofrojnë përfytyrim për të ardhmen, bazuar në ndryshimet e përgjithshme shoqërore dhe politike të cilat mund të kenë ndikim në artin e ndërtimit dhe politikën e mjedisit, etj.

Një numër i arkitektëve kanë projektuar apo i kanë dhënë nocion objekteve të cilat përfaqësojnë modele mbresëlënëse të parimeve ekologjike, duke i kontribuar dizajnit eco-miqësor dhe nivelit të lartë të sajimit estetik. Në raste të tilla mund të kuptohet që ambienti/ mjedisi është i po të njëjtës rëndësi sikurse edhe objekti, ndoshta edhe më i rëndësishëm, sepse objekti duhet të marrë dhe merr frymë në hapësirën e cila e rrethon pa marrë parasysh çfarë është ajo.



Emilio Ambasz: "Ndërtesa ACROS", Fukuoka – Japoni

Duhet të ri-definohet se çka është natyra në vete dhe çka është natyra e krijuar nga njeriu. Të merret shembulli i Japonisë, vend në të cilin druri ekziston për arsye se është mbjellur nga njeriu ose ndokush ka vendosur të mos e largoj nga vendi ku ka qenë. Mund të thuhet se është e domosdoshme të krijohet definicioni i ri për natyrën e krijuar nga njeriu (man-made nature). Një definicion i tillë do të duhej të përfshijë dhe zgjeroj jo vetëm krijimin e hapësirave të gjelbëruara dhe publike, por edhe krijimin e arkitekturës e cila duhet të shihet si pamje e përshtatshme e natyrës së krijuar nga njeriu. Në lidhshmëri me këtë Emilio Ambasz shkon thajse në thelb të çështjes së dizajnit të gjelbër dhe rolit kujdestarë të njerëzimit në mirëmbajtjen e natyrës. Njerëzimi ka qenë gjithmonë pjesë themelore e strukturës ekologjike, arkitektura e të cilit shumë shpesh siguroi bazë për mbijetimin e botës bimore dhe shtazore.

Në këtë kontekst mund të përmenden objektet me forma biomorfe të identifikuara si struktura të cilat gëlltisnin në një mënyrë aspektet e ndryshme të mjedisit apo natyrës.



Peter Vetsch: Shtëpita Muller – Dietikon, Zvicër

Si të gjithë arkitektët e “gjelbër” (green architects) në ditët e sotme, veprat e Peter Vetsch-it shtrojnë pyetje shqetësuese në lidhje me atë se çfarë shprese ekziston në ngadalësimin e ngritjes së papërgjegjshme të strukturave të mëdha (mega-structures) të cilat rrezikojnë të gjitha parimet e Epokës së Ekologjisë. Përdorimi i formave gjarpërore, materialeve vendore dhe shkrirja e strukturës në topografinë përkatëse, janë po aq pasqyrim i kriterëve etike sa edhe zgjedhjes estetike.

Ndër faktorët bazë në reagim ndaj të ashtuquajturit model ekologjik është të kuptohet kapaciteti i natyrës si i tillë që më parë lejon objekti të futet në të sesa të largohet nga ajo.

Si forcim i reputacionit/ famës/ emrit tashmë të njohur të Charles Jencks – it është “Kopshti i meditimit kozmik” i cili njëherit konsiderohet si kryevepër dhe ndër veprat e rralla bashkëkohore të referuara në një rrjetë astrofizike. Sipas mendimit të Jencks-it, format e ndërlikuara të pranishme në këtë kopsht tregojnë në të njëjtën kohë konfiguracionet organike të natyrës në kombinim me çrregullimet kaotike të gjithësisë.



Charles Jencks: Kopshti i Meditimit Kozmik, Skotlandë

Informatën, përvojën dhe përjetimin e forcave të dikurshme të natyrës në krijimin e planetit tonë, mund ta gjejmë në Qendrën Evropiane “Vulcania” të projektuar nga arkitekti austriak Hans Hollein. Është një kompleks dramatik i ndërtuar në një lartësi prej 1000m dhe kryesisht i gdhendur mbi kupën e një vullkani të shuar. Këtij kompleksi me qëllim i është dhënë një cilësi e fortë e gjithësisë dhe një cilësi rituali në përshtatshmëri me aspektin mistik apo enigmatik të shkencës mbi vullkanet. Ky rast me të drejtë prek tërthorazi zbritjen në qendër të tokës, në skëterrën e Dante-s (Dante’s inferno). Pa dyshim, përdorimi i materialeve vullkanike, përfshirja në topografinë ekzistuese si dhe ndjeshmëria për tërë hapësirën ku ndodhet, e vënë këtë kompleks në ballë të ashtuquajturave “skulptura” të mjedisit.



*Hans Hollein: Qendra europiane "Vulcania",
St. Ours-les-Roches, Auvergne, Francë*

Nga pikëvështrimi i mekanizmave simbolik të cilët e lidhin objektin me kontekstin e tyre kulturor si dhe arrijnë një poezi të dukshme arkitekturore, asnjë nga realizimet në ditët e sotme nuk e kalon Qendrën Kulturore Marie Tjibaou në Kaledoninë e Re të projektuar nga Renzo Piano. Më konkretisht shikuar, në këtë kompleks kemi përdorimin e materialeve dhe metodave

tradicionale të ndërtimit duke mos lënë anash në asnjë mënyrë elementet natyrore siç janë: era, drita dhe bimësia. Me përfundimin e kësaj qendre, Piano duket sikur ka arritur të pamundurën në kuadër të arkitekturës bashkëkohore. Ka krijuar një urë të banueshme e cila dërgon kah shekulli 21 dhe e cila materializon të kaluarën, të tanishmen dhe të ardhmen.

E dhënë e dukshme e cila paraqitet në veprat e arkitektëve të lartpërmendur është ndjeshmëria ndaj mjedisit apo ambientit si dhe përdorimi i materialeve natyrore dhe bimësisë apo vegjetacionit, gjë që admirohet nga ana e shëndetit publik dhe zgjedhjes artistike të arsyeshme.



*Renzo Piano: Qendra Kulturore Jean-Marie Tjibaou,
Noumea – Kaledonia e Re*

Në grupin e objekteve të orientuara kah arkitektura ekologjike (Eco-architecture) hyjnë edhe objektet në konstruksionin e të cilëve përdoren shtresat apo faqet e mureve të cilat në mënyrë efikase grumbullojnë rrezet e diellit, lejojnë rrymimin e ajrit me temperaturë të kontrolluar në tërë enterierin si dhe bëjnë të mundur përfshirjen e bimësisë/vegjetacionit në brendësi. Parimet të cilat udhëheqin këtë sistem të gjelbër diellor bazohen në marrëdhëniet (simbiozën) në mes të njeriut dhe natyrës.

LOG ID është grup i formuar nga Dieter Schempp në përbërje të arkitektëve, inxhinierëve, mjekëve, botanistëve, fizicientëve dhe ekspertëve të teknologjisë së komunikimit, të cilët me punën e tyre kanë arritur të bëhen ndër kontribuuesit më të mëdhenj në lëmin e studimeve të energjisë së diellit dhe eko - teknologjisë. Biblioteka dhe Qendra Kulturore në Herten është shembull i arkitekturës ekologjike dhe solare i cili u lejon shfrytëzuesve që të thithin ajrin e pastër dhe kënaqen me ndjenjën e mirëqenies në vendin e punës apo gjatë leximit. Që të arrihet deri te më e larta në aspektin e bukurisë së objektit ndikim ka ambienti mjaft i theksuar psikologjik i bazuar në programin e dizajnit të ndjeshëm ekologjik.³



LOG ID/ Dieter Schempp: Biblioteka dhe Qendra Kulturore/ Glasshouse, Herten – Gjermani

.....Vështrimi në arkitekturën e gjelbër fillon me qasjen në arkitekturën organike me ç'rast edhe mund të përfundon

³ Mendim: F.L.W: Studioni natyrën, dashuroni atë, qëndroni pranë saj. Kurrë nuk do të ju dëshpëroj. (www.geocities.com/SoHo/1469/flw)

duke theksuar se kjo arkitekturë nuk është vetëm një stil nostalgjik. Gjithmonë do të frymëzoj dhe magjeps, është duke u ri-mishëruar në ditët e sotme si një lëvizje ndërkombëtare e cila bashkon respektin ndaj natyrës si dhe bukurinë, harmoninë e formave natyrore, rrjedhave dhe sistemeve. Si një valë, ky model i ri dhe ngacmues është duke e përshkruar botën dhe në të njëjtën kohë duke e transformuar arkitekturën dhe dizajnin në shekullin 21. Derisa shkenca shikon gjithnjë e më thellë në botën mikroskopike të përbërjes së lëndës dhe zbulon gjithnjë e më shumë strukturat e mrekullueshme, natyra vazhdon të na befasoj dhe mësoj se si do të ndërtojmë/ projektojmë më me mençuri dhe mprehtësi si dhe në mënyrë më ekonomike dhe ekologjike.....⁴

Bibliografia

- F. Kennedy, Joseph; G. Smith, Michael; Wanek, Catherine;** *THE ART OF NATURAL BUILDING – design, construction, resources*: New Society Publishers, Canada (2002)
- Pearson, David;** *NEW ORGANIC ARCHITECTURE – the breaking wave*; The University of California Press
- Stang, Alanna; Hawthorne, Christopher;** *THE GREEN HOUSE: New Directions in Sustainable Architecture* (2005)
- Taschen;** *SMALL ECO HOUSES (Evergreen Series)* (2007)
- Wines, James;** *GREEN ARCHITECTURE*; Benedikt Taschen Verlag GmbH, Koln (2000)

Burime nga Interneti

- www.ambasz.com (parë për herë të fundit më: 15/11/2008)
- www.franklloydwright.org (parë për herë të fundit më: 05/02/2009)
- www.geocities.com/SoHo/1469/flw (parë për herë të fundit më: 05/02/2009)
- www.earthhouse.info (parë për herë të fundit më: 10/02/2009)
- www.charlesjencks.com (parë për herë të fundit më: 20/12/2008)

⁴ Mendim: F.L.W: Arkitekti duhet të jetë vizionar, vizionar në kuptim të plotë të fjalës: nëse nuk është në gjendje të sheh së paku dhjetë vjet përpara atëherë mos e quani arkitekt. (www.geocities.com/SoHo/1469/flw)

www.hollein.com (parë për herë të fundit më: 20/12/2008)

www.agsn.de (parë për herë të fundit më: 25/12/2008)

<https://194.185.232.3/works/037/pictures> (parë për herë të fundit më: 10/10/2008)